



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORATI

Nr. 3065/1 prot.

Tiranë, më 18.10.2023

URDHËR

Nr. 155, datë 18.10.2023

**“PËR  
MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PUNËSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK ME  
KOHË TË PJESSHME PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024, NË  
FAKULTETIN E MJEKËSISË, UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin dhe në Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në procedurën e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë për vitin akademik 2023-2024, në Udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. 2 datë 14.09.2023, i ndryshuar “Për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, në shkresën e Fakultetit të Mjekësisë, Nr. 2345/40 Prot. Datë 11.10.202, protokolluar me tonën Nr. 3065 prot. Datë 11.10.2023, “Miratim dhe publikim i vendeve vakante për personel akademik me kohë të pjesshme në Programin e studimit “Msc Mjekësi e Përgjithshme dhe Farmaci” nga Departamentet e FM, vendet vakant në programet e Studimit Bachelor dhe MSC “Shëndet Publik dhe vendet vakant për Modulet e Dekanatit të FM”, pas verifikimit të tyre referuar përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi:

URDHËROJ:

- I. Miratimin e propozimeve të Njesisë Kryesore (Fakulteti i Mjekësisë), në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për personelin akademik me kohë të pjesshme.
- II. Miratimin e kriterëve dhe dokumentacionin për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (sipas shtojcës Nr.1 bashkëlidhur Urdhrit)

- III. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Fakulteti i Mjekësisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
- IV. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORI**  
**ARBEN GJATA**



## SHTOJCA Nr.1

### A. Kriteret që duhet të plotësojë personeli akademik me kohë të pjesshme

1. Personeli akademik me kohë të pjesshme duhet të përmbushë kriteret dhe kërkesat për punësim, në të njëjtën mënyrë si personeli me kohë të plotë në UMT. Njësia bazë në bashkëpunim me Shërbimin do të përshtat kriteret sipas nevojave të tij në publikimin e vendeve të punës për personel akademik me kohë të pjesshme.

#### 2. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

- a) Të jetë diplomuar në programe të integruara ose Master Shkencor në degën përkatëse;
- b) Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku, kualifikim të ciklit pasardhës;
- c) Kandidatët duhet të kenë notë mesatare të studimeve universitare (cikli i dytë) 8 e lart;
- d) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- e) Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë;
- f) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- g) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- h) Të zotërojnë me dëshmi një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Europian (Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht, Italisht, Spanjisht);

3. Njësia bazë, mbështetur në nevojat e saj, përcakton kritere të veçanta shtesë për vendet e punës, mbështetur në kategorinë e personelit që kërkohet të punësohet.

### B. Dokumentacioni që do të dorëzohet nga personeli akademik me kohë të pjesshme:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar njësisë bazë ku do të konkurrojnë/ kandidojë;
2. Curriculum Vitae e detajuar me gjithë aktivitetin shkencor dhe botuese e kandidatit;
3. Leje nga punëdhënësi në organizatën ose institucionin ku punon;
4. Dokument identifikimi;
5. Fotokopje të noteruara të diplomës dhe listë së notave të të gjitha programeve të studimit (Bachelor, Master Shkencor, Program të Ciklit të Tretë të Studimeve (Specializim Afatgjatë në Fushën e Mjekësisë /Doktoraturë);
6. Fotokopje të noteruara të vërtetimit të ekuivalentimit të diplomës nga MAS, si diplomë, listë notash si dhe njohje të gradave për kandidatët që kanë studiuar jashtë shtetit;
7. Kopje të noteruara të dëshmive të gjuhëve të huaja të mbrojtura (*e detyrueshme të paktën një*);
8. Kopje të noteruar të librezës së punës;
9. Vërtetim page, shoqëruar me derdhjen e sigurimeve shoqërore nga qendra e punës;

10. Vërtetim i gjendjes shëndetësore të marrë brenda tre muajve të fundit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
11. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti) nga *e-albania*;
12. Dy referenca nga të cilat të paktën njëra të jetë nga një profesor i Institucionit në të cilin është diplomuar (*dorëzohet vetëm nëse kandidati aplikon për herë të parë*).
13. Çdo dokument tjetër që vërteton kriteret specifike dhe ato preferenciale të publikuara nga Njësia Kryesore (Fakulteti i Mjekësisë).

Kandidatët për personel akademik me kohë të pjesshme duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme, kriteret preferenciale dhe dokumentacionin sipas përcaktimeve në njoftimin publik në faqen zyrtare të Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

**Dokumentacioni do të dorëzohet pranë zyrës së Protokoll-Arkivës në Fakultetin e Mjekësisë, fizikisht ose nëpërmjet shërbimit postar me listë inventari.**

**Afati është 7 (shtatë) ditë pune, afat i cili fillon nga e nesërmja e shpalljes së njoftimit në Buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik.**

Të gjithë të interesuarit, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit në buletin e APP-së mbi shpalljen për konkurrim, personel akademik me kohë të pjesshme (Pedagogë të Jashtëm), në Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë, të vizitojnë faqen zyrtare të internetit <https://www.fakultetimjekesise.edu.al> si dhe atë të UMT-së <http://www.umed.edu.al>, me qëllim njohjen me kriteret specifike, afatet dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë (përfshirë dhe dokumentacionin specifik), për të konkurruar për personel akademik me kohë të pjesshme.

### **C. MËNYRA E VLERËSIMIT:**

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e arsimit të lartë, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, etj.

Për çdo paqartësi mund të dërgohet e-mail në adresën [info@umed.edu.al](mailto:info@umed.edu.al)